



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 12 dt. 18.04.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.04.2014, pasi shqyrtoi kërkesën për konfirmim të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI sh.a” ,

VENDOSI:

1. Shoqëria “AYEN AS ENERGJI sh.a” duhet t’i drejtohet Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik, për të rifirmosur kontratën dy palëshe mes Shoqërisë dhe ASHA.
2. Bazuar në nenin 47 të ligjit “Për Trashëgiminë Kulturore”, KKR jep miratim për fillimin e punimeve për shoqërinë “AYEN AS ENERGJI sh.a” për ndërtimin e HEC-eve “Gojan, Gjegjan, Peshqesh dhe Ura e Fanit/Fangu” mbi lumin Fan i Madh dhe Fan i Vogël, në rrethet Mirditë dhe Pukë.
3. Kryerja e të gjithë procedurave të realizohet nën supervizimin e Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI